



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2023:211068
Datë: 19.12.2023
Numri i dokumentit: 05093526

C.nr.731/2023

Gjykata Themelore në Pejë, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Bajram Cacaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Zh.R. nga Komuna e Deçanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokatura “Krasniqi & Partners” sh.p.k., me avokatët Xh.K. dhe I.N. dhe bashkëpunëtorja E.B. me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria e Arsimit, me seli në Deçan, me objekt kontesti pagesë mbi bazën e përqindjes së inflacionit, me vlerë të kontestit 1.587,72 €, jashtë seance më datë 19 dhjetor 2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË padia me numër C.nr.731/2023, e datës 5 tetor 2023 e paditësit Xh.R. kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria e Arsimit, lidhur me çështjen e pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit, për shkak të ekzistimit të gjyqëvarësisë (litispedencës)

A r s y e t i m

Paditësi Xh.R., nga Komuna e Deçanit, përmes përfaqësuesve me autorizim ka ushtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria e Arsimit, për pagesë mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

Gjykata ka gjetur se paditësi Xh.R. nga Komuna e Deçanit me numër personal ..., nga Komuna e Deçanit, për çështjen e njëjtë pranë kësaj gjykate ka ushtruar edhe një padi tjetër me datë 13.01.2023, kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, e cila udhëhiqet sipas shenjës C.nr.141/2023.

Gjykata pasi analizoj të dy lëndët C.nr.731/23 dhe 141/23, e posaçërisht parashtrasat për precizimin e tare, gjati së bëhet fjalë për çështjen e njëjtë, mirëpo meqenëse lënda C.nr.141/2023 është proceduar më herët, atëherë gjykata vendosi ta hedhë poshtë padinë në këtë çështje për shkak të litispedencës.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 262 par.4 lidhur me nenin 391 pika c. të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Dega në Deçan
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.731/2023, datë 19.12.2023

Gjyqtari
Bajram Cacaj

KËSHILLË JURDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.